

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6902
E martë, 23 maj 2023
Çmimi 0.40 €

Qeveria e Kosovës thotë se komunat në veri do të funksionalizohen

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SENATORËT AMERIKANË CHRIS MURPHY DHE GARY PETERS VIZITOJNË KOSOVËN | FAQE 3

SENATORËT AMERIKANË: MARRËDHËNIET TONA VETËM DO TË FORCOHEN EDHE MË TEJ, SERBIA MOS TA PENGOJË KOSOVËN



REPUBLIKA E KOSOVËS - PRESIDENTJA
REPUBLIC OF KOSOVO - THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - PREDSEDNICA

Senatorët amerikanë Chris Murphy dhe Gary Peters kanë nisur të hënën vizitën në Kosovë në kuadër të një turni njëjavor në shtetet e rajonit të Ballkanit Perëndimor. Ata vizitën e parë e kanë pasur me presidenten

Vjosa Osmani, e cila u ka uruar mirëseardhje në Prishtinë. Senatori amerikan Chris Murphy në një konferencë për medie ka thënë se Serbia duhet të ndalojë së penguari Kosovën që të anëtarësohet në

organizata ndërkombëtare, ndërkaq senatori Peters i vlerësoi lart raportet në mes të Kosovës dhe ShBA-së dhe premtoi vazhdim të ndihmës dhe të bashkëpunimit nga Uashingtoni



24 VJET NGA MASAKRA NË BURGUN E DUBRAVËS, KËRKOHEM QË AJO TË TRAJTOHET NË DIALOGUN ME SERBINË

FAQE 4-5

PROMOVOHET LIBRI I ARSIM BAJRAMIT "GJENOCIDI I SERBISË NË KOSOVË - ASPEKTE JURIDIKE"

FAQE 7



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

ABDIXHIKU: PUSHTETI NA THOTË SE ÇMIMET JANË NORMALIZUAR, NJË TJETËR PËRPEKJE MASHTRIMI

F. 8

BLOKU A5 RIKTHEHET NË OPERIM

F. 8

SPORT



PARAQITET TRAJNERI I KOSOVËS, RAMI HADAR

F. 10

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

“Meta” gjobitet 1.2 miliard euro për shkeljen e rregullave të BE-së

BRUKSEL, 22 MAJ - Kompania “Meta”, që ka në pronësi “Facebook”-un, është gjobitur 1.2 miliard euro për shkak të transferimit të të dhënave të përdoruesve të Bashkimit Evropian në Shtetet e Bashkuara. Ky transferim i të dhënave është bërë në kundërshtim me një vendim paraprak gjyqësor, tha rregullatori në Irlandë më 22 maj. Komisioni irlandez për Mbrojtjen e të Dhënave, që vepron në emër të Bashkimit Evropian, tha se Bordi Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave ka urdhëruar vendosjen “e gjobës administrative prej 1.2 miliard eurosh”. Komisioni irlandez për Mbrojtjen e të Dhënave ka hetuar transferimin që ka bërë “Meta” të të dhënave personale të përdoruesve nga BE-ja në ShBA që nga viti 2020. Ky hetim gjeti se “Meta”, që ka selinë evropiane në Dublin, ka dështuar “t’i adresojë rreziqet e të drejtave fundamentale dhe lirive të të dhënave të përdoruesve” që

paraprakisht ishin identifikuar se u ishin transferuar të dhënat, sipas vendimit të Gjykatës për Drejtësi të Bashkimit Evropian. Kjo gjykatë interpreton ligjet e BE-së dhe sigurohet që ato të aplikohen në të njëjtën mënyrë në të gjitha shtetet anëtare. Në përgjigje, “Meta” tha se ishte “e zhgënjyer” që vetëm kjo kompani është veçuar dhe se vendimi “është i padrejtë dhe vendos një precedent të rrezikshëm për dhjetëra kompani të tjera”. “Ne do të apelojmë vendimin, që përfshin edhe gjobën, dhe ne do të kërkojmë nga gjykata t’i pushojë afatet e zbatimit të vendimit”, thanë presidenti i “Meta”-s për çështje globale, Nick Clegg, dhe shefja ligjore e kompanisë, Jennifer Newstead. “Meta” tha se shpreson që në muajt në vijim ShBA-ja dhe BE-ja të miratojnë një kornizë të re ligjore që do të lejonte përdorimin e të dhënave personale. Për këtë çështje ishte arritur një marrëveshje



paraprake vitin e kaluar, sipas cilës, do të lejohej praktika e transferimit të të dhënave. Në gjashtë muajt e fundit rregullatorët e BE-së e kanë gjobitur katër herë kompaninë “Meta”, tri herë vetëm gjatë këtij viti, lidhur me shkeljet e bëra nga “Instagram”, “WhatsApp” dhe

“Facebook”. Në janar, Bordi evropian i Mbrojtjes së të Dhënave e gjobiti me 300 milionë euro gjigantin e medieve sociale për shkak të shkeljes së rregullave gjatë përdorimit të reklamimit të shënjestruar në aplikacionet e tij. Në mars, “Meta” u detyrua të

paguajë 5.5 milionë euro për shkak të shkeljeve të bëra nga “WhatsApp”. Gjopa e fundit, e iniciuar nga rregullatori irlandez, fillimisht synonte që “Meta” ta pezullonte transferimin e të dhënave. Por, rregullatorët e tjerë të BE-së kërkuar që “Meta” të gjobitej.

Mësimdhënësit në Rumani hyjnë në grevë për paga më të mira

BUKURESHI, 22 MAJ - Dhjetëra mijëra mësimdhënës rumunë hynë në grevë më 22 maj duke kërkuar rritje të konsiderueshme të pagave dhe duke bërë thirrje për më shumë investime në arsim. Rreth 100 000 - 150 000 mësimdhënës të shkollave fillore dhe të mesme ndaluan punën derisa kërkojnë që qeveria e koalicionit t’i përmbushë kërkesat e tyre. Bisedimet e minutës së fundit më 21 maj midis sindikatave të mësuesve dhe qeverisë së kryeministrit Nicolae Ciuca nuk arritën një marrëveshje dhe në këtë formë dështuan përpjekjet e qeverisë për t’i rikthyer mësimdhënësit në shkolla. Marcel Ciolacu, nga partia PSD, që do të jetë kryeministër i ardhshëm sipas rotacionit të vendosur nga koalicioni, dërgoi një mesazh të



vonuar të premten, përmes të cilit u tregua i “gatshëm” për të diskutuar gjatë fundjavës me krerët e sindikatave “për ta shmangur grevën e përgjithshme”.

Ai ua hodhi fajin sindikatave, duke thënë se “kjo grevë është e dëmshme jo vetëm për funksionimin e shkollave, por edhe në jetën e miliona familjeve”.

Ciolacu u përpoq të ushtronte presion mbi drejtuesit e sindikatave, duke shtuar se rumunët presin prej tyre - dhe nga politikanët - zgjidhje të qeta dhe

racionale “ndërsa fëmijët e shohin paqen e tyre në shkollë”. “Ishte obligim i qeverisë dhe i atyre që kanë role vendimmarrëse që të dalin me zgjidhje më të shpejta, siç kanë premtuar”, ka qenë përgjigja nga tri sindikatat e arsimit të Rumanisë të cilat organizuan grevën. Të dielën pasdite krerët e sindikatave morën pjesë në negociatat me kryeministrit Nicolae Ciuca dhe anëtarë të tjerë të ekzekutivit, por propozimi që iu dha nga qeveria nuk i kënaqi ata. Kërkesa kryesore e grevistëve është një pagë fillestare për mësuesit e rinj të paktën e barabartë me mesataren e vendit. Paga mujore e një mësuesi rumun të sapodiplomuar është pak më shumë se 520 dollarë (480 euro), ndërsa paga mesatare në vend është 988 dollarë (rreth 913 euro).

Partia e Mitsotakis fiton zgjedhjet parlamentare në Greqi

ATHINË, 22 MAJ - Në zgjedhjet parlamentare të së dielës partia qeverisëse e Greqisë, Demokracia e Re, e cila udhëhiqet nga kryeministri grek Kyriakos Mitsotakis, shënoi një fitore të madhe, mirëpo nuk i fitoi numrat e nevojshëm për ta krijuar qeverinë e vetme, pa koalicion. Ky rezultat rrit gjasat që vendi të shkojë në balotazh brenda një muaji. Me shumicën e votave të

numëruara, Demokracia e Re, që është parti konservatore, mori një epërsi prej 40.8 %, duke mposhtur partinë e së majtës së thellë - Syriza, e cila qeverisi nga viti 2015 deri në vitin 2019, me 20.1 %. Sipas parashikimeve të Ministrisë së Brendshme të Greqisë, Demokracia e Re pritet të sigurojë 145 vende në parlament, vetëm gjashtë vende më pak se që i duheshin për të krijuar një shumicë

absolute. Duke filluar nga e hëna, presidentja greke Katerina Sakellariopoulou do t’u japë tri partive kryesore - Demokracisë së Re, Syriza-s dhe PASOK-ut socialist - tri ditë radhazi për të tentuar të formojnë një qeveri koalicioni. Nëse të gjitha dështojnë, Sakellariopoulou do të emërojë një qeveri të përkohshme për t’i përgatitur zgjedhjet e reja rreth një muaj më vonë.



SENATORËT AMERIKANË CHRIS MURPHY DHE GARY PETERS VIZITOJNË KOSOVËN

Senatorët amerikanë: Marrëdhëniet tona vetëm do të forcohen edhe më tej, Serbia mos ta pengojë Kosovën



Senatorët amerikanë Chris Murphy dhe Gary Peters kanë nisur të hënën vizitën në Kosovë në kuadër të një turni njëjavor në shtetet e rajonit të Ballkanit Perëndimor. Ata vizitën e parë e kanë pasur me presidenten Vjosa Osmani, e cila u ka uruar mirëseardhje në Prishtinë. Senatori amerikan Chris Murphy në një konferencë për medie ka thënë se Serbia duhet të ndalojë së penguari Kosovën që të anëtarësohet në organizata ndërkombëtare, ndërsaq senatori Peters i vlerësoi lart raportet në mes të Kosovës dhe ShBA-së dhe premtoi vazhdimin e ndihmës dhe bashkëpunimit nga Uashingtoni

vlerësoi lart raportet në mes të Kosovës dhe ShBA-së dhe premtoi vazhdimin e ndihmës dhe bashkëpunimit nga Uashingtoni. “Do të vazhdojmë t’i shohim mundësitë për të ofruar bashkëpunim në sigurinë kibernetike dhe për përmirësimin e raporteve me forcat ushtarake të ShBA-së dhe për ndërveprimin me forcat e tjera në mbarë Evropën”, ka theksuar Peters.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka garantuar se Kosova do t’i zbatojë të gjitha marrëveshjet e arritura në dialog dhe nuk do t’u ikë detyrimeve. “Ky takim i sotëm vjen nga vizita që kisha në ShBA. Marrëdhënia e Kosovës me ShBA-në është e rëndësishme dhe ekzistenciale. Të dyja dhomat e senatit kanë luajtur rol kyç. Kosova është partner kyç i ShBA-së. Kosova ka luajtur rol kyç edhe në politikën e jashtme, duke vënë sanksione ndaj Rusisë pas luftës në Ukrainë si dhe me strehimin e refugjatëve sirianë dhe afganë”, ka thënë Osmani, e cila ka folur edhe për

marrëveshjen e fundit Kosovë - Serbi në Ohër. “Sa i përket marrëveshjes në Bruksel dhe Ohër, Kosova nuk do t’u ikë detyrimeve. Kosova do t’i zbatojë të gjitha detyrimet e saj që janë si rezultat i dialogut. Multietniciteti është vlerë e mishëruar në Kushtetutën tonë”, ka thënë Osmani.

Vizita e dy senatorëve në Kosovë vjen disa ditë pasi Komiteti për Punë të Jashtme i Senatit amerikan mbajti një seancë për politikën e Uashingtonit në Ballkanin Perëndimor.

Në këtë seancë folën këshilltari i lartë i Departamentit Amerikan të Shtetit, Derek Chollet dhe i dërguari i Uashingtonit për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar. Që të dy zyrtarët kërkuan nga Kosova dhe Serbia ta zbatojnë Marrëveshjen drejt normalizimit dhe Prishtina ta themelojë sa më shpejt Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe.

Dy senatorët amerikanë kanë takuar edhe kryeministrin Albin Kurti.

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 22 MAJ - Senatorët amerikanë Chris Murphy dhe Gary Peters kanë dhënë mesazhe të fuqishme në Prishtinë, duke rikonfirmuar edhe një herë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të qëndrojnë krahë për krahë Kosovës. Dy senatorët amerikanë u deklaruan për medie pas takimit që patën të hënën me presidenten e Kosovës Vjosa Osmani.

Senatori Murphy ka thënë se do të qëndrojnë një javë në rajon dhe vizitën e tyre e kanë nisur në Kosovë. “Nuk është koincidence që po fillojmë udhëtimin tonë në Kosovë. Kjo aleancë është e

fuqishme, e qëndrueshme dhe jetike. Kur ShBA-ja ka nevojë për ndihmë, thirrjet tona të para janë në Kosovë. Kosova është ndër shtetet e para që ngrehet në këmbë. Është bashkë me ShBA-në”, është shprehur ai. Senatori shtoi se e vlerësojnë punë e qeverisë për sundimin e ligjit. “E çmojmë shumë vëmendjen që qeveria po ia kushton sundimin të ligjit në një rajon kur ka ende nevojë për luftimin e korrupsionit”, ka potencuar ai.

Murphy ka deklaruar se do ta ndihmojnë Kosovën drejt rrugës së Bashkimit Evropian, duke theksuar se Serbia duhet të ndalojë të pengojë të drejtën e Kosovës për të qenë pjesë e organizatave botërore. “Na vjen

mirë që po e shohim marrëveshjen e fundit midis Kosovës dhe Serbisë që përfshin njohjen e ndërsjellë të dokumenteve zyrtare, por edhe hapat e vështirë që duhen të ndërmerren nga të dyja palët. Serbia duhet të ndalojë së penguari Kosovën, të drejtën e saj për të qenë pjesë e organizatave ndërkombëtare”, ka deklaruar Murphy.

Murphy ka pohuar se me këtë marrëveshje Kosova është zotuar se do ta lejojë themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, duke theksuar se shpreson se ky Asociacion do të themelohet “sa më shpejt që të jetë e mundur”.

Ndërkaq senatori Peters i



24 vjet nga masakra në Burgun e Dubravës, kërkohet që ajo të trajtohet në dialogun me Serbinë

**EPOKA
ERE****Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 22 MAJ - Në 24-vjetorin e masakrës së Dubravës, kryeministri Albin Kurti, kryetari i Kuvendit Glauk Konjufca, ministra dhe deputetë kanë bërë homazhe në nderim të 117 të burgosurve shqiptarë të vrarë mizorisht nga forcat e regjimit gjenosjen të Serbisë dhe plagosjen e 300 të tjerëve. Në fjalën e tij, kryeministri Albin

Kurti fillimisht ngriti lart figurën historike të Adem Demaçit, që vuajti 28 vjet burgim dhe Ukshin Hotit, që kaloi nëpër burgje nga viti 1981 deri më 1999, kur dhe u zhduk po në burgun e Dubravës më 16 maj 1999, fare pak ditë para masakrës që sot e përkujtuam.

Para të pranishmëve kryeministri shtoi se të burgosurit politikë shqiptarë në Jugosllavi ishin një kategori më vete që nuk mund të injorohej dhe as të shmangej, e

cila u dëshmuar në luftën e fundit, kur shteti i Serbisë i grumbulloi mbi 980 të burgosur politikë shqiptarë nga të gjitha burgjet, duke i grumbulluar në burgun e Dubravës për t'i eliminuar. "Ky plan dhe kjo 'zgjidhje përfundimtare' e ideuar nga Serbia, e bëri burgun e Dubravës një lloj kampi përqendrimi politik për të burgosurit politikë shqiptarë. Qëllimi ishte jo vetëm eliminimi i tyre politik, por edhe zhdukja e tyre fizike. Se çka

ndodhi në Burgun e Dubravës mes 19 majit dhe 24 majit të vitit 1999, më së miri kanë rrëfyer dhe na rrëfyer edhe sot dëshmitarët e atyre ngjarjeve, të burgosurit e mbijetuar të masakrës në burgun e Dubravës që, fatmirësisht, janë shumë", tha kryeministri. Ndonëse të burgosurit e mbijetuar, sikurse Enver Dugolli, Nait Hasani, Ukë Thaçi, Asllan Selimi e të tjerë autorë, e kanë rrëfyer historinë e masakrës në Burgun e Dubravës deri në detaje

bashkë me emrat e atyre që kryen këtë krim lufte, kryeministri shtoi se ata ende nuk janë nxjerrë para drejtësisë përkundër dëshmitarëve dhe dëshmitarëve.

Më tutje, ai vlerësoi se kjo vizitë, përveç për ta kujtuar masakrën e kryer nga Serbia mbi të burgosurit shqiptarë këtu, është edhe për ta denoncuar këtë krim lufte të kryer nga shteti serb, ngaqë Republika e Kosovës është shteti ynë që po ngrehet e po



Anëtarësimi në Europol e Interpol, ish-kryeinspektori i AKI-së: Duhet fushatë e fuqishme diplomatike

PRISHTINË, 22 MAJ - Ish-kryeinspektori i përgjithshëm i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI), Burim Ramadani, ka thënë se Kosova duhet të llojë jashtëzakonisht e të bëjë fushatë të fuqishme diplomatike që të bëhet anëtare e të gjitha organizatave rajonale dhe ndërkombëtare, sidomos të atyre të sigurisë.

Ai në një intervistë për "Ekonomia Online" ka deklaruar se vendi do të duhej që në të njëjtën kohë t'i evidentojë ndërhyrjet që po i bën Serbia brenda Kosovës dhe qëllimet që, sipas tij, janë të ndërlidhura me Rusinë. "Kosova duhet të llojë jashtëzakonisht më shumë, duhet të ketë një fushatë të fuqishme diplomatike informuese dhe evidentuese për nevojat që Kosova të jetë anëtare e të gjitha organizatave rajonale dhe ndërkombëtare, sidomos të

atyre të sigurisë dhe të njëjtën kohë t'i evidentojë ndërhyrjet që po i bën Serbia brenda Kosovës dhe qëllimet që janë të ndërlidhura me Rusinë. Pra duhet një evidentim tepër i saktë, tepër i qartë dhe si të tilla do ta bëjnë dallimin mes Kosovës që është pro perëndimore dhe Serbisë që është pro ruse", ka thënë ai.

Ai tha se anëtarësimi i Kosovës në organizatat e sigurisë, si ajo e Interpolit e Europolit dhe hapat konkretë drejt NATO-s, do të mundësonin rritjen e sigurisë kombëtare. "Gjasat mund të rriten atëherë kur Kosova bashkë me partnerët ndërkombëtarë do të organizojnë një fushatë informuese diplomatike gjithëshoqërore dhe gjithinstitucionale, pra nuk bëhet fjalë vetëm për një dikaster civil, por në kuptimin e përgjithshëm. Anëtarësimi i



Kosovës në organizata rajonale dhe ndërkombëtare të sigurisë, Interpol, Europol, rruga apo hapat me konkret drejt NATO-s,

do ta siguronin sigurinë kombëtare, do të garantonin sigurinë kombëtare të Kosovës. Ndërkaq aspektet e

kriminalitetit, krimin të organizuar dhe të tjera do të mbetnin sfida sikur për shtetet e tjera", ka theksuar Ramadani.

Policia e Kosovës pranon donacion pesë furgonë nga shteti gjerman



PRISHTINË, 22 MAJ - Në vazhden e përkrahjes dhe mbështetjes ndaj Policisë së Kosovës (PK), Policia Federale e Gjermanisë, në një ceremoni të organizuar të hënën, ka bërë dhurimin e radhës të një donacioni prej pesë automjeteve furgonë për Policinë Kufitare të PK-së.

Në ceremoninë e pranimit morën pjesë ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, zëvendës drejtori i përgjithshëm i PK-së, Fehmi Hoti, ambasadori i Gjermanisë, Jorn Rohde, stafi i lartë menaxhues dhe përfaqësues të tjerë. Ky donacion dëshmon

bashkëpunimin e fuqishëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Kosovës me atë të Gjermanisë, në veçanti me Policinë Kufitare, në luftimin e krimin të organizuar, atij trans-kufitar si dhe mbikëqyrjen dhe kontrollin e kufirit shtetëror.

Ministri Sveçla dhe zëvendës drejtori Hoti i falënderuan ambasadorin gjerman dhe Policinë Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin, përkrahjen dhe mbështetjen e vazhdueshme që shteti gjerman ka bërë dhe po bën ndaj Policisë së Kosovës.

forcohet dhe i cili nuk harron dhe nuk fal asnjë krim të bërë gjatë luftës. "Lavdi për të gjithë të burgosurit të vrarë në masakrën në burgun e Dubravës dhe secilës jetë të dhënë në rrugën tonë për lirinë e Kosovës!", tha në fund kryeministri Kurti.

Konjufca në fjalën e tij ka theksuar se forcat serbe i urdhëruan të burgosurit në Burgun e Dubravës që të grumbulloheshin, me arsyetimin se do t'i transferonin në një burg tjetër por, pak minuta më vonë, filloi një nga masakrat më të paimagjinueshme ndaj të burgosurve shqiptarë. "Policët serbë, në mesin e tyre edhe të burgosur serbë të liruar dhe të armatosur nga zyrtarët e burgut, filluan të qëllonin me armë automatike dhe të hedhin granata dore mbi trupat e ekspozuar të 980 të burgosurve, shumica prej tyre pengje lufte dhe të burgosur politikë. Për disa

ditë radhazi të atij maji të vitit 1999 ekzekutuesit serbë u futën brenda ambienteve të burgut duke qëlluar mbi këdo që gjenin, teksa të burgosurit përpiqeshin t'i ndihmonin të plagosurit dhe të gjenin një vend për t'u fshehur. Të mbijetuarit e kësaj masakre tregojnë se ato ditë jeta dhe vdekja qëndronin të zhveshura krejtësisht përballë fatit të kulluar, teksa dihej qartazi se ata po masakroheshin vetëm sepse ishin shqiptarë", ka thënë ai.

Konjufca ka theksuar se numri i të plagosurve mes qindra të mbijetuarve në Masakrën e Dubravës e tejkalon atë të të vrarëve. "Këta të mbijetuar janë që të gjithë dëshmitarë të ekzekutimit të organizuar në mënyrë shtetërore, brenda një burgu të shndërruar në kamp të shfarosjes në masë, nga aparati shtetëror gjenocidal i Serbisë. Ky krim kundër njerëzimit, një nga aktet e gjenocidit të Serbisë në

Kosovë, akoma nuk është ndëshkuar dhe drejtësia për të vrarët e për të mbijetuarit akoma nuk është vendosur në vend. Në këtë aktualitet politik ndërkombëtar të ndarë mes vendeve demokratike dhe vendeve që mbështetin aktivisht apo pasivisht spastrimin etnik, krimet kundër njerëzimit dhe gjenocidin si mjet lufte, marrja përsipër e çështjes së masakrës së Dubravës nga drejtësia ndërkombëtare nuk do të ishte vetëm drejtësi për viktimat, por do të ishte edhe konfirmim i qartësisë politike në sferën e vlerave të demokracisë dhe në rendin gjeopolitik", është shprehur Konjufca.

Edhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka përkujtuar 24-vjetorin e masakrës së Dubravës. "Afër një muaj përpara se Kosova të bëhej e lirë, makineria e pushtetit gjenocidal të Serbisë manifestoi egërsinë ndaj të

burgosurve shqiptarë në Burgun e Dubravës me ç'rast, në periudhën 19-24 maj 1999, vrau brenda burgut 160 të burgosur shqiptarë dhe plagosi 300 të tjerë. Ata po mbaheshin në burg padrejtësisht si pengje të luftës e në kundërshtim me të gjitha rregullat e të drejtës ndërkombëtare. Masakra e Dubravës është një nga krimet me të tmerrshme të regjimit kriminal serb gjatë vitit 1999, prandaj drejtësia për të gjitha viktimat dhe të mbijetuarit do të jetë triumfi i së vërtetës", ka thënë Osmani.

Ajo ka theksuar se në këtë përvjetor kujtojmë sakrificat, vuajtjet dhe mundimet e këtyre të burgosurve që kontribuan për çështjen kombëtare të cilët qëndruan stoikisht e nuk u thyen deri në frymën e fundit. "Kujtim dhe nderim i përhershëm për ta, sikurse edhe angazhim i pareshtur për ndëshkimin e këtij

krimi duke sjellë autorët para drejtësisë", është shprehur Osmani në deklaratën për medie. Nait Hasani, i mbijetuar i masakrës së Burgut të Dubravës, kujtoi ditët kur ish-të burgosurit shqiptarë ishin grumbulluar më 30 prill të vitit 1999.

Hasani tha se shteti serb ka tentuar t'ia lë fajin NATO-s për masakrën e Dubravës. Madje ai ka kërkuar që masakra e Dubravës të trajtohet në dialogun me Serbinë. "Kjo masakër ka ndodhur me paramendim nga shteti serb, e menduar deri në fund se si të bëhet vrasja. Kështu së bashku më 30 prill 99 na sollën në burgun e Dubravës. Me këto veprime shihet qartë qëllimi i shtetit serb për të vrarë sa më shumë të burgosur si hakmarrje ndaj UÇK-së. Ne si ish-të burgosur kërkojmë nga institucionet që masakra e Dubravës të trajtohet në dialogun me Serbinë", ka thënë Hasani.

Fëmija 4 vjeç kishte përpirë monedhën 2 euro, mjekët e QKUK-së ia heqin me sukses



PRISHTINË, 22 MAJ - Një fëmijë i moshës katërvjeçare nga Mitrovica kishte përpirë një monedhë metalike, e cila kishte depërtuar në lukth, duke ia rrezikuar seriozisht shëndetin. Pas komplikimit të gjendjes shëndetësore, fëmija ishte shtrirë në Klinikën e Kirurgjisë së Fëmijëve në QKUK. "Janë ndërmarrë masat

e nevojshme reanimatore nga anesteziologët e Klinikës së Anesteziologjisë dhe pastaj specialistët e Klinikës së Gastroenterologjisë me Hepatologji dhe, përmes metodave endoskopike, fëmijës ia larguan monedhën metalike nga lukthi. Fëmija tani gëzon shëndet të plotë dhe po mbikëqyret nga stafi i

Klinikës së Kirurgjisë së Fëmijëve. Mjekët apelojnë te prindërit që të kenë kujdes të shtuar dhe mos të lejojnë që fëmijët të mbajnë monedha metalike dhe gjësende të imëta që mund t'i gëlltitin dhe t'u shkaktojnë telashe shëndetësore", ka njoftuar Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës.

Shqipëria, mikpritëse e 24 mijë trupave ushtarake për 'Defender 23'

IRANË, 22 MAJ - Shqipëria për herë të dytë është bërë mikpritëse e stërvitjes së përbashkët shumëkombëshe drejtuar nga Komanda Evropiane e ShBA-së "Defender Europe". Në këtë stërvitje marrin pjesë 24 mijë trupa ushtarake shqiptare, evropiane dhe amerikane.

Në ceremoninë e hapjes së stërvitjes në sheshin "Nënë Tereza" në Tiranë paraditen e së hënës morën pjesë personalitete të larta të shtetit dhe ushtrisë shqiptare, ambasadorja amerikane në Shqipëri, Yuri Kim, si dhe drejtues të lartë ushtarakë amerikanë. Nëpër disa stenda ishin ekspozuar armatime të ndryshme.

Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, tha se rëndësia e kësaj stërvitjeje është më e prekshme se kurrë dhe se vazhdueshmëria e kësaj manovre ushtarake është më se e nevojshme për rajonin e Ballkanit Perëndimor. "Shqipëria

është e përkushtuar në misionin e saj si faktor stabilizues në Ballkan dhe eksportuese e sigurisë në rajon e më gjerë", theksoi presidenti.

Ndërsa kryeministri Edi Rama tha se Shqipëria është e privilegjuar që është mikpritëse e kësaj stërvitjeje për herë të dytë. "Shqipëria ka nderin të presë për herë të dytë stërvitjen më të madhe ushtarake në Evropë. Ky është një privilegj i posaçëm për Forcat tona të Armatosura, që janë pritëse dhe pjesëmarrëse. Për herë të dytë kjo stërvitje vë në pah përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve tona ushtarake falë edhe mbështetjes së aleatëve tanë amerikanë dhe të tjerë të vendeve të NATO", tha Rama.

Ai shtoi se Shqipëria nuk ka qenë kurrë më lart "në nivelin e respektit ndërkombëtar". "[Shqipëria] sot është ulur në Këshillin e Sigurimit të Kombeve

të Bashkuara si bashkëpëmbajtëse për çështjen e Ukrainës. Kjo është përgjegjësi e jashtëzakonshme, që vë në dukje çfarë pjekurie dhe zhvillimi ka arritur vendi ynë", tha Rama.

Ambasadorja amerikane tha se kjo stërvitje tregon se ShBA-ja, së bashku me vendet aleate, mund të kryejnë çdo mision. "Që dy vjet që prej Defender 2021, bota ka ndryshuar, Shqipëria dhe aleatët tanë të NATO-s janë më të bashkuar dhe më të fortë se kurrë. Nuk mund të mos kujtoj fjalët e Skënderbeut: bashkimi bën fuqinë. Që nga Defender 2021, Shqipëria dhe ShBA-ja po bëjnë më shumë se kurrë më parë së bashku. Kemi ngritur dy pranitë e para ushtarake të ShBA-së në historinë e Shqipërisë. Defender 2023 do të na tregojë se së bashku me aleatët dhe partnerët ne mund të kryejmë çdo mision. Jemi krenarë që e quajmë Shqipërinë aleate dhe



mike", tha Yuri Kim. Shefi i Shtabit të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, Arben Kingji, tha se kjo stërvitje tregon gatishmërinë e Shqipërisë dhe aleatëve të saj se janë të përgatitur për të përballuar çdo sfidë. Në këtë stërvitje marrin pjesë 800 trupa ushtarake shqiptare, ndërsa marrin pjesë edhe ushtarakë nga 10 vende të

ndryshme evropiane dhe nga ShBA-ja. Për këtë stërvitje janë sjellë 7 000 pajisje nga ShBA-ja si dhe 13 mijë të tjera që janë nxjerrë nga depot e armatimeve të pozicionuara aktualisht në zonat ku do të kryhet stërvitja, e cila do të zgjasë deri më 2 qershor.

Stërvitja "Defender 2023" nisi një ditë më parë në Kosovë.

MPJD-ja hap edicionin e 9 të Shkollës Diplomatike Pranverore

PRISHTINË, 22 MAJ - Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, përkatësisht Akademia Diplomatike, në bashkëpunim me fondacionin gjerman "Friedrich-Ebert", ka hapur të hënën punimet e edicionit të 9 të Shkollës Diplomatike Pranverore.

Në ceremoninë e hapjes, diplomatëve nga 35 shtete të botës u është drejtuar presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu.

Duke u uruar mirëseardhje në Republikën e Kosovës, presidentja Osmani ka thënë se Shkolla Diplomatike është një prej organizimeve më të



rëndësishme të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës e cila sjell në Kosovë

diplomatë nga mbarë bota për t'i krijuar e për t'i forcuar kështu edhe më tej raportet

dipomatike mes tyre. Presidentja Osmani, gjithashtu, u shpreh se Kosova ka shënuar përparim në politikën e jashtme dhe se anëtarësimi në BE dhe NATO është synimi kryesor.

Drejtori i përgjithshëm i Akademisë Diplomatike, Beqir Ismaili, u shpreh se edicioni i nëntë pasqyron nevojën për të kuptuar dhe për t'i përgatitur diplomatët për sfidat dhe mundësitë e diplomacisë ekonomike në një mjedis gjithnjë e më të globalizuar. Ndërkaq, drejtori i FES-it, Rene Schlee, tha se organizimi i Shkollës Diplomatike është një

mundësi e jashtëzakonshme për të ndërtuar ura komunikimi mes shteteve dhe diplomatëve të rinj që synojnë përfaqësimin e politikave ndërkombëtare. Ai shtoi se tashmë tema e zgjedhur e këtij viti, që lidhet me diplomacinë ekonomike, ka një rëndësi parësore për të gjitha shtetet.

Edicioni i nëntë i Shkollës Diplomatike Pranverore ka mbledhur rreth 40 diplomatë të rinj nga 35 shtete të ndryshme të botës të cilët për pesë ditë do të qëndrojnë në Kosovë. Ata, përveç trajnimit, do të vizitojnë edhe vende historike dhe kulturore të Kosovës.

Gazetarët ukrainas dhe afganë pajisjen me kartela udhëtimi nga trafiku urban

PRISHTINË, 22 MAJ - Deri në fund të vitit 2023 gazetarët ukrainas dhe afganë të strehuar në Kosovë do të udhëtojnë falas në të gjitha linjat e Trafikut Urban në Prishtinë. Këtë vendim e ka miratuar komuna e Prishtinës, me kërkesën e paraqitur nga Asociacioni i

Gazetarëve të Kosovës, për t'i pajisur me kartela 18 gazetarë të strehuar në Kosovë në kuadër të programit "Gazetarët në Rezidencë - Kosovë". Kartelat e udhëtimit ua kanë dorëzuar të hënën drejtoresha ekzekutive e AGK-së, Getoarabë Mulliqi-Bojaj dhe kyreshefi

ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike "Trafiku Urban", Burim Maraj. Asociacioni i Gazetarëve i Kosovës e falënderon për gatishmërinë dhe bashkëpunimin e frytshëm komunën e Prishtinës dhe Ndërmarrjen Publike "Trafiku

Urban". Gazetarët janë strehuar në Kosovë në kuadër të programit Journalists in Residence - Kosovo, i cili është iniciuar nga European Centre for Press and Media Freedom ECPMF, kurse mbështetet financiarisht nga Qeveria e Republikës së



Kosovës, Misioni i OSBE-së në Kosovë si dhe iniciativa Hannah Arendt.

Promovohet libri i Arsim Bajramit 'Gjenocidi i Serbisë në Kosovë - aspekte juridike'

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (AShAK) ka promovuar librin e Arsim Bajramit "Gjenocidi i Serbisë në Kosovë - aspekte juridike", në të cilin paraqiten dëshmi për gjenocidin e Serbisë në Kosovë. Libri ka 625 faqe. Parathënia dhe rezymeja janë në gjuhën angleze e frënge dhe ka mbi 1 000 fusnota e referenca bibliografike

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 MAJ - Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (AShAK) ka promovuar librin e Arsim Bajramit "Gjenocidi i Serbisë në Kosovë - aspekte juridike". Libri ka 625 faqe. Parathënia dhe rezymeja janë në gjuhën angleze e frënge dhe ka mbi 1 000 fusnota e referenca bibliografike.

Gjyljeta Mushkolaj, profesoreshë e Drejtësisë në Universitetin e Prishtinës, ka thënë se qëllimi i librit është që brezat që vijnë të kenë përgjegjësi që t'i përcjellin kujtimet e viktimave dhe të mbijetuarve të gjenocidit serb. Sipas saj, detyrën e nisur nga profesori Bajrami duhet çuar deri në fund, në mënyrë që të

dëshmohet përgjegjësia e Serbisë e të mos përsëritet e kaluara. "Qëllim madhor i librit është që brezi ynë dhe brezat që vijnë do të kenë përgjegjësi për ta përcjellë kujtimin e viktimave dhe të mbijetuarve të gjenocidit të Serbisë në Kosovë që në mënyrë të përsëritur e ka përcjellë popullin tonë sidomos gjatë luftës së fundit duke e mbajtur shtetin serb ndërkombehtarisht përgjegjës për gjenocid për krimet", ka thënë ajo, duke shtuar se ky libër ka arritur të dëshmojë dhe dokumentojë që gjenocidi nuk ndodhi pa paralajmërim dhe, sipas saj, ky është thelbi i gjenocidit që e dallon atë nga gjenocidet e tjera. "Sot detyra jonë që profesor Bajrami e nis është që të çojmë deri në fund dhe ta bëjmë të përgjegjshëm



shtetin e Serbisë dhe kështu mund ta ndalojmë që të mos përsëritet e kaluara", ka thënë Mushkolaj.

Recensenti i këtij libri, profesor Jusuf Bajraktari, ka thënë se ky

libër bazohet në tri qëllime: e para të argumentojë ligjërisht se krimet e Serbisë në Kosovë plotësojnë pesë kriteret e Konventës së OKB-së, e dyta të paraqesë argumente për kryerjen e krimeve gjenocidiale dhe e treta studimi synon që ta tregojë të vërtetën për luftën në Kosovë. "Libri aspekte juridike paraqet një studim profesional dhe shkencor, i cili trajton gjenocidin në Kosovë duke analizuar krimet në Kosovë. Objekti kryesor i këtij studimi është argumentimi juridik. Krimet e Serbisë në Kosovë paraqesin kombinacionet e politikave gjenocidiale të Serbisë në Kosovë. Studimi paraqet një hulumtim disaveçar të autorit për analizimin e burimeve vendore dhe ndërkombëtare", është shprehur Bajraktari. Profesori i të Drejtës Penale Ndërkombëtare, Ismet Salihu, ka thënë se ky botim është i rëndësishëm së veçantë në aspektin juridik-penal, historik e

kushtetues si dhe në aspektin ndërkombëtar. "Botimi është 620 faqe, është me rëndësi të veçantë në aspektin juridik - penal, historik kushtetues dhe në aspektin thjesht kombëtar. Krimi i gjenocidit është krimi më i madh që mund të kryente gjatë luftës", ka thënë ai.

E autori i këtij librit, profesor Arsim Bajrami, ka thënë se ky libër është një kontribut profesional në argumentimin juridik të gjenocidit të Serbisë në Kosovë me fakte konkrete juridike. "Kjo është më së e domosdoshme në kohën kur ka tendenca të mohimit dhe relativizimit të këtij gjenocidi, vendosjes së baraspeshës mes gjenocidit serb dhe ndonjë krimi individual gjatë luftës në Kosovë. Këto tendenca tentojnë ta rishkruajnë historinë e luftës së drejtë dhe çlirimtare të UÇK-së, duke inkriminuar themeluesit e saj dhe liderët kryesorë të lirisë dhe pavarësisë së Kosovës", ka thënë Bajrami.



Qeveria e Kosovës thotë se komunat në veri do të funksionalizohen

PRISHTINË, 22 MAJ - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është duke bashkëpunuar me kryetarët e zgjedhur të komunave në veri të Kosovës për t'i organizuar seancat e asambleve komunale si dhe betimin solemn të kryetarëve, bëri me dije kreu i kësaj ministrie, Elbert Krasniqi.

Betimi para Kuvendit Komunal i kryetarit të zgjedhur të komunës është një procedurë solemne që shënon marrjen e detyrës. Ministri Krasniqi tha për "Radion Evropa e Lirë" se të hënën, më 22 maj, do të jepen të gjitha informacionet se kur dhe ku do të mbahen seancat e asambleve komunale në komunat Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan. Megjithatë, ai theksoi se ende nuk janë saktësuar lokacionet për mbajtjen e seancave. "Ende jo.

Jemi në proces e sipër. Ekipet janë duke punuar për t'i definuar të gjitha këto procese", tha Krasniqi.

Deri më tash betimin solemn para Kuvendit Komunal e ka bërë vetëm kryetari i ri i Mitrovicës së Veriut, Erden Atiq, më 19 maj.

Kryetarët e zgjedhur të tri komunave të tjera të veriut të Kosovës, të banuara me shumicë serbe, Izmir Zeqiri në Zubin Potok, Lulzim Hetemi në Leposaviq dhe Ilir Peci në Zveçan, ende nuk e kanë bërë betimin solemn.

Për dallim nga Zubin Potoku, i cili e ka asambleenë komunale funksionale, dy komunat e tjera, Leposaviqi dhe Zveçani, ende nuk i kanë të funksionalizuara ato.

Kryetarët e komunave nuk mund ta kryejnë betimin pa funksionalizimin e asambleve



komunale para të cilave solemnisht marrin detyrën. Ministri Krasniqi nuk ka dhënë detaje se si do të funksionalizohen ato dhe në cilat objekte, si dhe ku do të funksionojë infrastruktura që mundëson punën e institucioneve

komunale. Komuna e Mitrovicës së Veriut ka objektin e saj, ndërkohë që në tri komunat e tjera deri më tash në të njëjtat objekte komunale kanë punuar institucionet komunale sipas sistemit të Kosovës, por edhe

të ashtuquajturat organe të përkohshme të cilat punojnë sipas sistemit të Serbisë.

Zgjedhjet për kryetarët e katër komunave në veri të Kosovës janë mbajtur më 23 prill, pasi kryetarët paraprakë nga partia më e madhe e serbëve në Kosovë, Lista Serbe, dhanë dorëheqje nëntorin e vitit të kaluar. Ata u larguan nga institucionet në shenjë pakënaqësie me një vendim të Qeverisë së Kosovës për reregjistrimin e automjeteve që bartnin targa ilegale të lëshuara nga Serbia, në targa legale RKS - Republika e Kosovës.

Pjesëtarët e komunitetit serb gjerësisht bojkotuan zgjedhjet e prillit dhe thanë se nuk i pranojnë rezultatet, përkatësisht kryetarët e rinj nga komuniteti shqiptar.

Bloku A5 rikthehet në operim

PRISHTINË, 22 MAJ - Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ka njoftuar se blloku A5 është rikthyer në operim. Sipas KEK-ut, “pas fazës testuese, njësi A-5 është rikthyer në operim”. “Korporata

Energjetike e Kosovës (KEK) ju njofton se njësi A5, pas përfundimit të remontit kapital dhe eliminimit të të gjitha vërejtjeve të evidentuara gjatë fazës testuese, kjo njësi është rikthyer në operim sot pas

mesnate me datë 21 maj”, thuhet në njoftimin për medie.

KEK-u ka bërë me dije se sot në operim ka tri njësi të termocentralit “Kosova A” dhe një njësi të termocentralit “Kosova B”.



Kosova i bashkohet EFSA-së në fushatën për ta parandaluar murtajën afrikane të derrave

PRISHTINË, 22 MAJ - Autoriteti Evropian i Sigurisë Ushqimore (EFSA) së bashku me Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës kanë bashkuar forcat në një fushatë për ta mbështetur luftën kundër murtajës afrikane të derrave (ASF).

Në vitin e saj të katërt, fushata “Stop ASF” po rrit ndërgjegjësimin e fermerëve, gjuetarëve dhe veterinerëve në 18 vende evropiane, duke përfshirë Kosovën, për këtë sëmundje shumë ngjitëse. “Gjatë dekadës së fundit murtaja afrikane e derrave ka pasur një ndikim dramatik në sektorin evropian të rritjes së derrave dhe vazhdon t’i prishë ekonominë lokale dhe rajonale. Shifrat e fundit tregojnë shenja inkurajuese se përpjekjet për ta ndaluar përhapjen e virusit mund të kenë efekt, situata në të gjithë Evropën në përgjithësi nuk është aspak pozitive dhe ne duhet të qëndrojmë vigjilentë. Fermerët, gjuetarët dhe veterinerët



kanë një rol veçanërisht të rëndësishëm për raportimin e rasteve të dyshimta”, ka thënë drejtori ekzekutiv i EFSA-s, Bernhard Url.

Fushata inkurajon fermerët, veterinerët dhe gjuetarët të identifikojnë, parandalojnë, raportojnë rastet e ASF-së. “Edhe këtë vit, sikur në dy

vitet e mëparshme, jemi të lumtur që jemi pjesë e shteteve të përfshira në kampanjën kundër ASF-së. Për dallim, këtë vit Murtaja

Afrikane e Derrave, ndonëse jo e pranishme, është më afër kufijve të vendit tonë. Andaj, urojmë që gjithçka të shkojë ashtu si në vitet paraprake dhe ta arrijmë ndërgjegjësimin dhe ndikimin në audiencën përkatëse. Angazhimi nga ana jonë padyshim nuk do të mungojë andaj edhe shpresojmë për korrijen e rezultateve pozitive”, ka deklaruar zëvendësuesi i kryeshefit të AUV-it, Flamur Kadriu.

Në vitin 2022 numri i shpërthimeve të ASF në derra dhe popullatat e derrave të egër ra ndjeshëm në vende të tilla si Rumania, Polonia dhe Bullgaria krahasuar me një vit më parë, sipas një raporti të ri të publikuar sot nga EFSA.

Megjithatë, ASF u rikthye në Greqi dhe Çeki dhe vazhdon të përhapet në vendet fqinje me BE-në si Serbia dhe Moldavia. Është shfaqur në Maqedoninë e Veriut për herë të parë në vitin 2022.

Abdixhiku: Pushteti na thotë se çmimet janë normalizuar, një tjetër përpjekje mashtrimi



PRISHTINË, 22 MAJ - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka reaguar pas deklamimeve të ministrit të Financave, Hekuran Murati, se, gjoja, ka rënie të çmimeve. Sipas Abdixhikut, ky deklaram i pushtetit është një tjetër përpjekje për mashtrim, duke shtuar se rritja e tyre po vazhdon. “Pushteti na thotë se

çmimet janë normalizuar. Një tjetër përpjekje mashtrimi. Po jua vizatoj. Çfarë është blerë me 105 euro në shkurt të vitit 2021, sot duhet të blihet me 127 euro”, ka shkruar Abdixhiku në “Facebook”, duke shtuar se rritja e çmimeve vazhdon. “Sepse paaftësia kushton e propaganda s’bën zgjidhje. Burimi: Agjencia e Statistikave, nga vetë Zyra e Kryeministrit”,

ka shkruar Abdixhiku. Ditë më parë Murati është shprehur se çmimet kanë filluar t’i kthehen normalitetit. “Shkalla e inflacionit për muajin prill sipas ASK-së ishte 6.3 për qind, që paraqet një rënie të theksuar krahasuar me nivelin që kishim disa muaj më parë. Çmimet kanë filluar t’i kthehen normalitetit”, ka thënë Murati.

Ministrja Hajdari, vizitë zyrtare në Izrael

PRISHTINË, 22 MAJ - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, ka udhëtuar për vizitë në Izrael. Ajo do të ketë disa takime të rëndësishme gjatë qëndrimit në Izrael, duke e filluar takimin e parë me ministrin e Ekonomisë, Nir Barkat, për të diskutuar për thellimin e marrëdhënieve dypalëshe

ekonomike dhe tregtare në mes të Kosovës dhe Izraelit. Hajdari gjatë qëndrimit në Izrael do të takohet edhe me presidentin e Federatës së Dhomave të Tregtisë së Izraelit, Uriel Lynn dhe kryetarin e Grupit të Miqësisë Izrael - Kosovë, Erez Malul. Takimet e tjera në vijim përfshijnë Ministrinë e

Turizmit, Bashkinë e Jerusalemit, Institutin e Eksportit të Izraelit dhe ndërmarrësit izraelitë të industrisë dhe teknologjisë, të cilëve nga ekipi i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë do t’u paraqitet industria e Kosovës në rritje dhe përparësitë e të bërit biznes në Republikën e Kosovës.



Pesë këshilla të lashta nga Sun Tzu, që mund t'ju ndihmojnë të kapërceni konfliktet

Nga Kevin DIKINSON

Pak libra të tjerë mund të pretendojnë të kenë një ndikim aq të madh në historinë e luftës sa "Arti i Luftës" i Sun Tzu. I shkruar në Kinë rreth 2500 vjet më parë, ky traktat ushtarak themeloi një ideologji të luftës që do të bënte jehonë deri në Revolucionin Komunist të Mao Ce Dunit.

Duke u përhapur në të gjithë Azinë Lindore, ai udhëhoqi shtresën e luftëtarëve të Japonisë gjatë epokës së saj të dominuar nga lufta dhe diktoi taktikat e ushtarëve vietkongë në Vietnam. Sot libri "Arti i Luftës" studiohet në akademitë ushtarake në mbarë botën. Kjo vepër mbetet ende e rëndësishme, pasi autori i tij e njohu konfliktin si një pjesë universale të jetës.

Ai nuk u mjaftua vetëm me rishikimin e taktikave të betejave të kohës së tij. Ai u përpoq të eksploronte psikologjinë e luftës dhe se si ne mund ta shfrytëzohim atë me mençuri. Trajneri brazilian Luiz Felipe Scolari e ka përmendur shpeshherë këtë libër si frymëzim për taktikat që përdori për të fituar Kupën e Botës 2002.

Këshillat e tij janë zbatuar në fusha shumë të gjera duke nisur nga politika, menaxhimi i biznesit dhe madje edhe sportet. Ja cilat janë 5 citate të Sun Tzu që mund t'ju ndihmojnë të kapërceni strategjikisht konfliktin kudo që mund ta hasni.

1. Ata që fitojnë çdo betejë nuk janë vërtet të aftë. Ata që i bëjnë ushtritë e të tjerëve të pafuqishme pa luftuar janë më të mirët nga të gjithë.

Për të, fitorja më e madhe nuk është mposhtja e kundërshtarit përmes forcës, zgjuarsisë apo forcës së vullnetit. Ajo ka të bëjë me shmangien e plotë të betejës. Një person i mençur, thotë Sun Tzu, ka aftësinë dhe mençurinë për të zgjidhur një konflikt përpara se të fillojë. Për shembull, një diplomat i mençur mund të bëjë që dy kombe të zgjidhin një mosmarrëveshje për token përpara përshkallëzimit të dhunshëm. Në mënyrë të ngjashme, një mik i mençur di të përdorë humorin për të lehtësuar tensionet përpara se të shpërthejë një debat. Në të dyja rastet, fitorja gjendet në mungesën e konfliktit.



2. Nëse i njihni të tjerët dhe veten, nuk do të jeni të rrezikuar as në 100 beteja. Por nëse nuk i njeh të tjerët, por njeh veten, do të fitosh një betejë dhe do të humbësh një tjetër. Nëse nuk i njeh të tjerët dhe nuk e njeh as veten, do të jesh i rrezikuar të humbësh në çdo betejë.

Sipas tij, njerëzit emocionalisht inteligjentë kanë vetëdijen për të kuptuar motivet e tyre, për të njohur synimet e tyre dhe për të rregulluar emocionet. Duke e njohur veten, ata nuk fillojnë konflikte të panevojshme, dhe as nuk lejojnë që emocionet negative të çojnë në shpërthime ose veprime të pamenduara.

Në mënyrë të ngjashme, ata mund të përdorin inteligjencën e tyre emocionale për të zhvilluar vetëdijen sociale. Një aftësi e tillë i ndihmon ata të kuptojnë motivimet dhe emocionet e të tjerëve përmes dhembshurisë dhe simpatisë. Kjo njohuri mund të ndihmojë në parandalimin e konflikteve pasi personi emocionalisht inteligjent do të krijojë kushte që i bëjnë të tjerët të mos dëshirojnë një grindje me të. Gjithsesi edhe nëse lind një konflikt, inteligjenca emocionale

mund të ndihmojë në krijimin e situatave që i japin fund nevojës për grindje tek personi tjetër. Tek libri i tij, Sun Tzu rendit pesë tipare të rrezikshme që mjegullojnë gjykimin e gjeneralëve dhe i çojnë ata në konflikte të panevojshme. Këto janë zemërimi, lakmia, krenaria, pamaturia dhe të qenit më shumë sesa duhet mbrojtës ndaj të tjerëve. Këto tipare, thotë ai, sjellin fatkeqësi. Sot mund të themi se ato e pengojnë inteligjencën emocionale dhe prishin qetësinë tonë.

3. Pamposhtshmëria qëndron tek vetja jonë, cënueshmëria është tek kundërshtari.

Kjo këshillë pasqyron pikëpamjen stoike të kontrollit. Ju nuk mund të kontrolloni se si sillet dikush tjetër; por mundeni të dalloni sjelljen e tyre. Megjithatë, ju keni kontroll mbi veprimet tuaja, gjë që do të thotë se mund të përgatiteni për konflikt dhe të forconi mbrojtjen tuaj përpara veprimit.

Në luftë, përgatitje të tilla mund të përfshijnë mbajtjen e moralit lart, të kuptuarit e vlerës së një terreni të caktuar dhe mbajtjen e një zinxhiri të fortë komandimi. Në strategjinë e biznesit, mund të nënkuptojë forcimin e partneriteteve, gatishmërisë për t'u distancuar nga një vendim i keq, apo punësimin dhe zhvillimin e talenteve më të mira. Në nivelin personal, mund të

përfshijë zhvillimin e besimit, zotërimin të vetvetes dhe vetë-efikasitetit për të mbrojtur veten dhe besimet tona.

4. Përdor rendin për t'u përballur me kaosin, përdor qetësinë për t'u përballur me zhurmën

Çrregullimi dhe zhurma e mjegullojnë vetëdijen tonë mbi situatën, i ngacmojnë emocionet tona negative dhe na shtyjnë të marrim vendime të këqija thjesht për të kënaqur nevojën për të bërë diçka. Pra çdo gjë, mjafton të ketë një ndryshim. Por kjo e bën më të mundshëm konfliktin dhe kur ndodh, është më problematik për t'u menaxhuar.

Mjerisht që të dyja janë të zakonshme në jetën moderne. Ndërsa ne mund të mos kemi shumë ndikim mbi kaosin dhe çrregullimin në botën e jashtme, ne mund ta zgjidhim zhurmën nga brenda. Pasi konflikti bëhet i pashmangshëm, ne nuk duhet ta lëmë atë të na shqetësojë apo ta shohim si një mjet për të ndëshkuar një person tjetër për përfitimin tonë.

Në vend të kësaj, ne duhet të vendosim ta zgjidhim atë, të minimizojmë dëmet dhe të ruajmë qetësinë përballë sfidave të tij. Kjo kërkon jo vetëm shmangien e 5 tipareve që përmend Sun Tzu – zemërimin, lakminë, krenarinë, pamaturinë dhe mbrojtjen e

tepruar – por edhe të mësojmë t'i përshtatim përgjigjet tona ndërsa zhvillohet konflikti.

5. Konsideratat e një njeriu inteligjent përfshijnë gjithmonë përfitimin dhe dëmin. Ndërsa ata mendojnë përfitimin, puna e tyre mund të zgjerohet. Kur mendojnë dëmin, mund të zgjidhen problemet e tyre.

Në prag të një konfliktit, dëshira për përfitime mund të na nxitë të veprojmë në mënyrë agresive. Këto mund të jenë përfitime materiale, ndëshkimi emocional i të tjerëve apo rritje e fuqisë sonë shoqërore. Sido që të jetë, ndjekja e një përfitimi të perceptuar mund të na bëjë të harrojmë dëmin e mundshëm që mund të sjellë agresioni.

Në të njëjtën mënyrë, ne mund të largohemi nga konfliktet e nevojshme nëse mendojmë vetëm për dëmet e mundshme. Në vend të kësaj, Sun Tzu rekomandon që t'i marrim parasysh të dyja veçmas. Duke i njohur përfitimet dhe duke planifikuar për to, ne i bëjmë ato më të mundshme. Anasjelltas, duke paramenduar se çfarë mund të shkojë keq dhe dëmet që mund të lindin edhe nëse kemi sukses, ne mund të ndërmarrim hapa për t'u mbrojtur kundër tyre. / "Big Think" – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport



Më 3 qershor fillon turniri tradicional 'Labinot Aliaj - Labi'

Istog, 22 MAJ - Më 3 qershor do të mbahet turniri tradicional (futboll i vogël) "Labinot Aliaj - Labi". Këshilli Organizativ ka njoftuar se paraqitja e ekipeve do të bëhet çdo ditë nga data 22 maj, në numrin kontaktues 044493601. Turniri do të

mbahet në fushën e "Ibos" në Istog. Për fituesit e vendit të parë dhe të dytë do të ketë edhe shpërblime. Labinot Aliaj - Labi ka ndërruar jetë në nëntor të vitit 2020 dhe ky turnir tradicional mbahet në përkujtim të tij. Labinoti ishte asamblist në Kuvendin

Komunal të Istogut, një djalë modest, kreativ, shembull për rininë, me plot energji dhe zë i fuqishëm i rinisë në qytetin e Istogut. Labi ishte ndër tifozët më të flaktë të FC Istogut, ishte gjithmonë i pranishëm në tribuna, duke e përkrahur klubin e zezrës.



Paraqitet trajneri i Kosovës, Rami Hadar

Trajneri Rami Hadar, që ditë më parë e shpalli skuadrën e Pejës kampione të Kosovës në basketboll, të hënën edhe zyrtarisht është paraqitur trajner i Përfaqësueses A të Kosovës në basketboll. Marrëveshja është deri në vitin 2026 dhe synohet kualifikimi në "Eurobasket 2025"

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 22 MAJ - Rami Hadar edhe zyrtarisht është trajner i Përfaqësueses së Kosovës në Basketboll. Prezantimi i Hadar u bë të hënën nga kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës, Arben Fetahu, kurse marrëveshja e nënshkruar është trevjeçare. Numri një i basketbollit në vend ka thënë se është nder që Hadari ka pranuar që ta drejtojë Kosovën

dhe se me trajnerin izraelit priten rezultate të mira në ndeshjet ndaj Danimarkës dhe Zvicrës në parakualifikimet për "Eurobasket 2025".

Kryetari i Federatës së Basketbollit, Arben Fetahu ka mohuar se përzgjedhja e Hadarit është bërë për shkak të suksesit me KB Peja, ku arriti të shpallet kampion por, sipas tij, vendimi është marrë disa javë më herë, derisa Fetahu me këtë rast ka



njoftuar se gjatë kësaj jave do të publikohen emrat e ndimhstrajnerëve të Përfaqësueses A. Trajneri në fjalë ka drejtuar klube si Maccabi Haifa, Maccabi Haifa dhe Maccabi Be'er Sheva. Nga ana tjetër, Hadari ka thënë se në Kosovë ndihet si në shtëpinë e vet dhe në momentin që ka

marrë ofertën e ka pranuar me shumë kënaqësi. Përveç rezultateve, ai synon që në përfaqësuesen e "dardanëve" të krijohet një gjeneratë e re. "Falënderoj Federatën për mundësinë e dhënë dhe këtë e shoh si sfidë në karrierën time që më është besuar kjo punë. Mund të them

se gjatë tre muajve këtu kam mësuar shumë për kulturën tuaj dhe kam takuar njerëz fantastikë që më kanë pritur mirë. Ndihem si pjesë e këtij vendi. Jam tepër krenar dhe do të jap më të mirën për këtë punë që të kemi rezultate të mira. Besoj në pasionin, ekipin dhe gjithë përkrahjen që do ta kem. Kështu që, falënderoj të gjithë Federatën që besoi në mua për të ma dhënë ekipin. Jam i bindur se do të kem rezultate të mira", ka thënë Hadar, i cili me këtë rast ka konfirmuar se në përfaqësuese do të ketë prurje të reja, por edhe natyralizime të tjera të lojtarëve. Hadar ka folur edhe për Kosovën si vend, duke e cilësuar edhe të bukur dhe me njerëz shumë mirëpritës.

Ademi falënderon Krasniqin që zgjodhi Kosovën të zhvillojë një meç të rëndësishëm



Prishtinë, 22 maj - Kryetari i FFK-së, Agim Ademi, ka pritur në takim boksierin Robin Haxhi Krasniqi. Gjatë këtij takimi ata kanë diskutuar kryesisht rreth meçit për mbrojtjen e titullit kampion, të cilin Krasniqi do ta zhvillojë në stadiumin "Fadil Vokrri" me 5 gusht. Për Krasniqin kjo është një ëndërr e kamotshme, e cila më në fund po bëhet realitet. Ai e falënderoi kryetarin

Ademi për mbështetjen e dhënë, duke mundësuar që mbrojtja e titullit kampion të bëhet në një ambient ku i jep mundësi një numri të madh të adhuruesve të jenë të pranishëm. "Haxhi Krasniqi përshëndeti punën e mirë që po bëhet në futbollin kosovar dhe përgëzoi kryetarin Ademi që, falë korrektësisë dhe përkushtimit, futbollistët kosovarë nëpër Evropë t'i

bashkohen Kosovës dhe të punojnë drejt suksesit. Kryetari Ademi e falënderoi Krasniqin për vizitën dhe për vendimin që Kosova të jetë vendi ku ai do të zhvillojë një meç boksi me kaq rëndësi, derisa i ofroi përkrahjen e tij", thuhet në njoftimin e FFK-së. Kryetari Ademi e nderoi Krasniqin me fanellën e Kosovës si dhe simbolin e Prishtinës "Hyjnesha në fron".

Kastrati, pas përplasjes së frikshme: Po ndihem mirë

PRISHTINË, 22 MAJ - një përplasje me një kundërshtar dhe mbeti i shtrirë në fushë por, pas intervenimit të mjekëve, ai është ngritur në këmbë, por sërish humbi ndjenjat në bankë. Mbrojtësi "dardan" në "Facebook" ka konfirmuar se është duke vazhduar kontrollet mjekësore dhe se

po ndihet mirë. "Jam në spital duke i bërë të gjitha kontrollimet e nevojshme me stafin mjekësor. Po ndihem më mirë. Faleminderit të gjithëve për mesazhet! Shihemi së shpejti", ka shkruar Kastrati, i cili është pjesë e Ujpestit që nga viti 2020.



Miami i pandalshëm, afër titullit në Konferencën e Lindjes

MIAMI, 22 MAJ - Miami Heat udhëheq 3-0 serinë e finaleve "play-off" në Konferencën e Lindjes pas fitores me rezultat 128-102 ndaj Boston Celticsit. Një ndeshje e dominuar nga

vendasit, që janë një fitore larg titullit në këtë kah të NBA-së. Vendimtar stoli i Miamit, nga erdhën 55 pikë. Vincent me 29 pikë ishte shënuesi më i mirë për Miamin, mbështetur nga

Robinsoni me 22 pikë e Martini me 18 pikë. Ndërsa Butler, gjithnjë lider në ndeshjet e para, realizoi 16 pikë. Te Bostoni mungoi lojtari lider, gjithnjë në ndjekje në këtë ndeshje, me

Tatum që realizoi 14 pikë e 10 rebounde, shumë pak për të fituar. Edhe ndeshja e katërt do të luhet në fushën e Miamit, që ka shansin të shpallet kampion në Lindje.



Në mënyrë madhështore mbyllet turniri 'Demush Mavraj', 'Rama Market' rrëmben vendin e parë

"Epoka e re"

ISTOG, 22 MAJ - Në mënyrë madhështore ka përfunduar turniri tradicional "Demush Mavraj", i cili është organizuar nga 7 deri më 20 maj. Turniri në futboll të vogël që është organizuar në shenjë respekti e nderimi për dëshmorin e kombit dhe arsimtarin e Edukatës Fizike, Demush Mavraj solli emocione, rivalitet dhe kulturë të rallë sportive. Për këtë meritat u takojnë fillimisht donatorëve, pastaj organizatorëve, ekipeve dhe secilit pjesëmarrës.

Në finalen e madhe ekipi i "Rama Market" doli më i suksesshëm se ai i "Niti Sh.PK", prandaj edhe e rrëmbeu Kupën. Shpërblim, ekipi fitues mori, përveç Kupës, edhe medalje dhe u shpall edhe portieri më i mirë. Shpërblim i takuan edhe 1 200 euro. Ndërsa lojtari më i mirë erdhi nga ekipi i dytë më i mirë i turneut "Niti Shpk". Ky ekip u shpërbllye edhe me medalje dhe 300 euro. "Miq e dashamirë, sportdashës dhe ju njerëz të vullnetit të mirë që secili me



mundësitë e juaja na ndihmuat në organizimin e turnirit tonë tradicional. Në emër të këshillit organizativ duam t'ju falënderojmë përzemërsisht për mbështetjen tuaj, mbështetje e cila e bëri turnirin tonë më madhështor si asnjëherë më parë. Ju jemi shumë mirënjohës me shpresën që herëve të tjera të jeni edhe më shumë të

kënaqur me punën dhe organizimin tonë. Na nderuat ne si organizatorë, nderuat familjen e dëshmorit, nderuat Istogun, Dukagjinin e krejt Kosovën. U pafshim me shumë befasi edicionin e ardhshëm e qofshi faqebardhë!", thuhet në letrën falënderuese të Këshillit Organizativ.

Edvin Kuç, 'Ylli i javës' në Superligë

PRISHTINË, 22 MAJ - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për javën e 35-të në Albi Mall Superligë i ka takuar futbollistit të FC Ballkani, Edvin Kuç, pasi në ndeshjen kundër Ferizajt shënoi golin e parë në fitoren 2-0 dhe ishte një nga më të mirët në fushën e gjelbër. Me këtë fitore FC Ballkani edhe zyrtarisht e siguroi titullin e kampionit për të dytin vit rresht. "Të shpallësh Ylli i Javës në xhiron kur edhe jemi rishpallur kampionë për herë të dytë radhazi është një kënaqësi e veçantë. Si kapiten jam krenar me ekipin dhe me ecurinë që kemi treguar në këtë edicion. Rruga për ta mbrojtur titullin kampion nuk ka qenë e lehtë. Kemi pasur shumë ndeshje, kemi lëshuar shumë pikë rrugës, por në fund



karakteri i skuadrës, puna e shtabit teknik dhe organizimi i mirë i klubit kanë bërë që sërish trofeu i kampionit të vijë në Suharekë. Këtë çmim, por edhe

titullin kampion, ia dedikoj kryesisht, tifozëve dhe familjes sime, e cila çdoherë më ka qëndruar afër", ka thënë Edvin Kuç për faqen zyrtare të FFK-së.

SHKURT

Khaka, drejtuesve të Arsenalit: Na duhen përforcime

Arsenali u dorëzua në luftën për titullin e kampionit në Angli pas humbjes nga Notinghami, e cila bëri që titulli të shkonte në duart e Manchester Cityt. Mesfushori shqiptar Granit Xhaka u ka bërë thirrje drejtuesve të klubit se nuk duhet të ndalen, por duhet të vazhdojnë të ecin përpara dhe të sjellin përforcime në afatin kalimtar të verës. "Ne kemi luajtur një sezon të mrekullueshëm, por duhet të vazhdojmë. Ne duhet të bëjmë një hap tjetër përpara sepse sezoni i ardhshëm do të jetë shumë më i vështirë. Ne e dimë këtë. Bordi dhe trajneri do të vendosin se çfarë do të ndodhë, por ne duhet të jemi gati për çdo gjë", ka thënë Xhaka. Edhe e ardhmja e Xhakës është shumë e paqartë, pasi është raportuar se shqiptari do t'i bashkohet Bayer Leverkusenit.

Kimmichi nuk largohet nga Bayerni

Ishte raportuar se mesfushori Joshua Kimmich do të largohet nga Bayern Muncheni në afatin kalimtar të verës dhe t'i bashkohet Barcelonës, por kjo gjë nuk do të ndodhë. Sipas gazetarit të mirënjohur të "Sky Sport", Florian Plettenberg, Barça nuk ka kontaktuar ende me lojtarin, kurse në anën tjetër Kimmich, që si agjent i vetes ka nisur negociatat e para me Bayernin për një zgjatje të kontratës. 28-vjeçari ka një kontratë aktuale që skadon në vitin 2025 me gjigantët e Gjermanisë.

Hamiltoni lë Mercedesin për Ferrarin

E ardhmja e Lewis Hamiltonit te Mercedesi është ende në pikëpyetje, duke parë që mes palëve ende nuk ka asnjë kontakt për rinovimin e kontratës. Siç bën me dije "Daily Mail", britaniku mund të bashkohet me Ferrarin në sezonin e ardhshëm, me skuadrën italiane që i ka ofruar plot 40 milionë paund shtat herë kampionit të botës. Sipas prestigjiozes britanike, "Kokëkuqja" beson se Hamiltoni mund ta rikthejë edhe njëherë titullin kampion në Itali dhe gjithashtu kërkon që britaniku ta thyejë rekordin e Michael Schumacherit në ngjyrat e veta. Kjo gjë do ta sillte sakrificën e pilotit të parë të Ferrarit, Charles Leclerc. Monegasku është përfolur kohët e fundit se mund të largohet nga Ferrari këtë sezon dhe se gjithashtu ka nisur bisedimet me Mercedesin. Ky do të ishte një shkëmbim i mirë mes palëve, ku të dyja skuadrat do të merrnin atë që donin.

Ancelotti mbron Viniciusin: I gjithë stadiumi e thërriste majmun, çmenduri

Real Madridi humbi nga Valencia (1-0) dhe kjo i kushtoi me vendin e dytë në La Liga, -1 pikë në raport me Atletico Madridin. Fundi i sfidës u shoqërua me kaos dhe tension. Nuk munguan as kartonët, me Vinicius Jr që u ndëshkua me karton të kuq pasi goditi kundërshtarin. Trajneri Carlo Ancelotti nuk e priti mirë atë që ndodhi në fundin e sfidës duke mbrojtur lojtarin e tij i cili gjatë gjithë sfidës ishte në shënjestër të tifozëve duke e ofenduar në kor. "I gjithë stadiumi bërtiste majmun ndaj Vinicius. Kanë nisur ofendimet që nga minuta e parë. Ajo që ndodhi këtu është me të vërtetë një mëkat. Këto episode racizmi nuk duhet të ndodhin. Mendoj që Liga ka një problem shumë serioz në këtë sens. I thashë Vinicius nëse dëshironte të vazhdonte, më pas i thashë që nuk është ai problemi, në të tilla raste ndeshja duhet ndërprerë. Nuk dua të flas fare për futboll. Jam shumë i acaruar", ka thënë Ancelotti.

Guardiola: Nuk e kisha menduar se do të fitoja pesë kampionate në Angli

Manchester City ka fituar titullin e nëntë në histori të klubit, derisa është i treti radhazi. Për "Citizens" është titulli i pestë nën udhëheqjen e trajnerit spanjoll Pep Guardiola, i cili ka synim të fitojë edhe Ligën e Kampionëve. Pasi kanë

festuar titullin e kampionit, Pep ka thënë se është e padrejtë që iu kërkohet patjetër të fitohet Liga e Kampionëve për t'i marrë vlerësimet e merituar. "Ndonjëherë është e padrejtë që të duhet të fitosh patjetër Ligën e Kampionëve në mënyrë që t'i

marrësh të gjitha vlerësimet e merituar. Megjithatë, e pranoj, e di se nuk do të jemi të kompletuar pa trofeun e Ligës së Kampionëve. Është mirë kur luan nën presion. Për mua është e nevojshme", ka thënë Guardiola.

Trajneri spanjoll ka thënë se nuk e kishte menduar se do të fitonte pesë kampionate në gjashtë vjet te City dhe është një sukses i jashtëzakonshëm. "Ajo që kemi arritur është e jashtëzakonshme dhe këtë e dinë të gjithë kundërshtarët

tanë. Ata e dinë se sa të jashtëzakonshëm jemi ne. Nuk e kisha çuar ndër mend që do të fitoja pesë nga gjashtë kampionate, tashmë duket diçka normale, por është diçka e madhe dhe koha do ta tregojë", ka shtuar Guardiola.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deonikarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollli 119 date 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 22.05.2023 bënë shpallje publike për dhënie e pronës së paluajtshme me qira.

Shpallje Publike

T-23-08

Qëllimi i ofertës: Dhënie me qira e hapësirave
1. Parcela me Numër: P-71208128-01090-15.

Kriteret e Dhënies: Dhënia e kontratës do të bazohet Çmimi më i lartë

Data e shpalljes: 22.05.2023

Sqarimi: deri me 05.06.2023

Kërkesa për pjesëmarrje: Data(t) për kërkesës deri: 05.06.2023
Behet ne e-Mail: poshtë shënuar ose në zyrën e Divizioni i shitjes dhe qirasë.

Dorëzimi i ofertave: Dorëzimi i ofertave bëhet ne formë fizike (zarf te mbyllur)

Afati i fundit i dorëzimit: 06.06.2023 në 11:00

Vendi i dorëzimit: Divizioni i shitjes dhe qirasë Trepça Sh.A.
Parku Industrial, Mitrovicë

AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtarë: <i>Trepça sh.a.</i>		
Adresa postare: <i>Parku inustrial</i>		
Qyteti: <i>Mitrovicë</i>	Kodi postarë: <i>40000</i>	Shteti: <i>Kosovë</i>
Kontakti: <i>Burim HAJDINI</i>		Telefoni: <i>+383 (0) 28 538 050</i>
Email: <i>hajdini_b@hotmail.com</i>		Faksi: <i>+383 (0) 28 539 202</i>
<i>www.trepacorporation.com</i>		



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 03.04.2023 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhëshme një vjeqare, KRM"Uniteti" Sh.A vendosi që më datë 23.05.2023 të shpall:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendit të punës:

Automekanik – Njësia Mitrovicë me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeqare) , me mundësi vazhdimi

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Punon në servisimin dhe riparimin e të gjitha llojeve të automjeteve.
- Teston dhe kontrollon rregullësinë për mbajtje në gjendje të rregullt pune të automjeteve,
- Teston dhe provon rregullësinë e punës së motorit, ndrruesit, boshtit rrotullues, alternatorit, frejt, përkuesit, lyrjen e motorit, pastrimin e filterave.
- Kryen edhe punë tjera të kësaj natyre sipas urdhërësës së eprorit të drejtëpërdrejtë

Kualifikimet e kërkuara:

- Të ketë diplomën e shkollës së mesme, drejtimi Automekanik ose diplomë të ndonjë qendre aftësimi profesional për Automekanik
- Të prezantoj letërnjoftimin
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

Kushtet e veçanta:

Punëtori gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do ti vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mundë të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë.

Konkursi do të jetë i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 23.05.2023 deri më datën 06.06.2023. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Driton Hamit Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e Gjimnazit "Lazgush Poradeci" Kievë.

- Mentori B.I shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB 601640726.

Negimije Bungu shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IV shfmu " Dy Dëshmorët " Pirane.

- Afrim Smjali shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme "Arkitekt Sinani".

Emrije Vilaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Naim Frasheri " Vlashnje.

- Autoservis Beni-VW AUDI-VAG shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB 80273029.

Xhelal Ninaj shpall te pavlefshme dëftesat e lp I - VIII shfmu " Ibrahim Fehmiu " Prizren.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollëshme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

Erna Jamini shpall te pavlefshme dëftesat shfmu " Fetah Sylejmani " Dragash.

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

Enes Konjuhi shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore nga kl. I-V të shkollës " Nexhmi Mustafa" Besi Prishtinë.

Bleona Konjuhi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I-V të shkollës "Nexhmi Mustafa" Besi Prishtinë.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

Amanta Shala nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

